



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 26997 prot.

Tiranë, më 14.08.2023

VENDIM

Nr. 54, datë 14.08.2023

PËR

“MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, TË CILËT STUDIOJNË NË NJË PROGRAM
STUDIMI TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAM STUDIMI TË INTEGRUAR, NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023, QË PËRFITOJNË
BURSË SIPAS KRITERIT EKONOMIK”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 903, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, pasi mori në shqyrtim Relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 2326 prot., datë 19.07.2023 “Mbi miratimin e listave të studentëve që përfitojnë bursë, për vitin akademik 2022-2023 sipas kriterit ekonomik, faza e gjashtë dhe e shtatë e aplikimeve”, në mbledhjen e datës 14.08.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e 2 (dy) studentëve, të cilët studiojnë në një program studimi të ciklit të parë dhe në një program studimi të integruar, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2022-2023, që përfitojnë bursë sipas kriterit ekonomik, faza e gjashtë dhe e shtatë e aplikimeve, (lista bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Efekti financiar total është 40,000 (dyzetë mijë) lekë dhe përballohet nga buxheti i shtetit si pjesë e grantit të mësimdhënies së vitit 2023.
3. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të UMT-së.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFFERI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ